



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2021:097767

Datë: 22.01.2026

Numri i dokumentit: 08351009

K.DH.SH.II.nr.1380/25

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Alajdin Terrshnjaku dhe Krenar Berisha, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit J.H. B.I me seli në Prishtinë adresa rruga “Rasim Kiqina”, nr. 55 kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga avokatura shtetërore, për shkak të heshtjes administrative dhe kompensim dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës–Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.686/22 të datës 26.06.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 15.01.2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me seli në Prishtinë.

II.VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.686/22 të datës 26.06.2025.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, ka vendosur si në vijim: Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit J.H. B.I me seli në Prishtinë për shkak të heshtjes administrative, Obligohet e paditura Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ta shqyrtoj kërkesën nga parashtruesi J.H. B.I të dorëzuar në MBPZHR me datë 02.03.2021 e paditësit e paditësit për shqyrtimin e lëndës të merr vendim dhe të njëjtin, t’ia dorëzoj paditësit dhe Komunës së Prishtinës, sipas procedurës së përcaktuar me ligj dhe ta njoftoj gjykatën. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të: shkeljeve aplikimit të gabuar të dispozitave dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, me

propozimin që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurit, të anulohet aktgjykimi i kontestuar dhe të lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje të gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe vlerësimit komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të zbatueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është **e pa-bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se përfaqësuesi i paditësit në pretendimet e dhëna në padi, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, paditësi në cilësinë e fermerit merret me kultivimin e pemëve dhe perimeve në fshatin Besi, Komuna Prishtinës, Në vitin 2017 për shkak të kushteve klimatike paditësi ka pësuar dëm me ç'rast i është drejtuar Komunës së Prishtinës për kompensim të dëmit. Pas daljes së Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve për shkak të fatkeqësive i njëjti ka vlerësuar dëmet ku në të gjitha kulturat ka vlerësuar se dëmi është në vlerë prej 25,438.00 euro, ndërsa fitimi i humbur në vlerë prej 36,340.00 euro. Ka shtuar se Qeveria e Republikës së Kosovës më datë 24.07.2018 merr një vendim me nr. 01/58 të datës 24.07.2018 për kompensimin e menjëhershëm të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore në bazë të vlerësimeve nga komisioni i veçantë nga Ministria e Financave, ndërkaq paditësi i pakënaqur edhe një herë i drejtohet Komunës së Prishtinës me një kërkesë për rishqyrtim të këtij rasti, ndërsa është njoftuar nga Komuna se në mungesë të mjeteve financiare lënda përcjellet në MBPZHR. Paditësi i është drejtuar Ministrisë përkatëse sipas njoftimit nga Komuna e Prishtinës në mënyrë që të shqyrtohet kërkesa e tij për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga ngricat e mëvonshme, mirëpo nuk ka marr asnjëherë përgjigje nga e njëjta. Në seancën e shqyrtimit kryesor ka precizuar kërkesëpadinë e tij duke theksuar se e kërkon kompensimin e dëmit real në shumën prej 25,438.00 euro me kamat ligjore në lartësi prej 8 % vjetore, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim në MBPZHR e datës 02.03.2021, e deri në pagesën definitive. Si përfundim gjykatës i ka propozuar që të aprovohet në tërësi si të bazuar kërkesëpadia e paditësit.

Përfaqësuesja e të paditurës në deklaratimet e saj të dhëna përmes përgjigjes në padi sipas parashtrësës së datës 06.0.2024, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, nga fakti se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural sipas ligjit përkatës mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, nuk ka pasur fond të veçantë për kompensimin e dëmeve eventuale në sektorin e bujqësisë. Procesi vlerësues i dëmit material i datës 25.04.2017 i bërë nga Komisioni i Formulari i Sektorit të Bujqësisë nga Komuna e Prishtinës nuk mund të prodhojë efekt juridik dhe se raporti nuk i plotëson kushtet të konsiderohet me efekt të ekzekutueshëm. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, me aktgjykimin ankimuar e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje

lenden tek e paditura (si në dispozitiv të këtij aktgjykimit). Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ndër tjerash ka konstatuar se: Komuna e Prishtinës me datë 19.02.2021, e ka njoftuar paditësin J.H. se sa i përket kërkesës së tij të datës 24.12.2020 Drejtoria e Bujqësisë në mungesë të mjeteve financiare lëndën me nr. të referencës 04-31/01-0091992/17 e ka përcjellë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Kërkesë për shqyrtimin e lëndës nga parashtruesi i kërkesës J.H. për MBPZHR me datë 02.03.2021, ku i njëjti i është drejtuar kësaj Ministrie ta shqyrtoj lëndën me nr. të referencës 04-31/01-0091992/17 për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga ngricat e vonshme në fermën-pemishten në fshatin Besi, Komuna e Prishtinës. Gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit për shkak të heshtjes administrative është e bazuar dhe se paditësit nga e paditura i është drejta për marrjen e një vendimi nga Komuna e Prishtinës dhe MMPH-ja si e drejtë e garantuar sipas me dispozitat ligjore dhe kushtetuese. Gjykata e vlerësoj kundërshtimi e të Paditures sipas parashtrësës së datës 06.0.2024, me arsyetim se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural sipas ligjit përkatës mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, nuk ka pasur fond të veçantë për kompensimin e dëmeve eventuale në sektorin e bujqësisë. Procesi vlerësues i dëmit material i datës 25.04.2017 i bërë nga Komisioni i Formuar i Sektorit të Bujqësisë nga Komuna e Prishtinës nuk mund të prodhoj efekt juridik dhe se raporti nuk i plotëson kushtet të konsiderohet me efekt të ekzekutueshëm, mirëpo vlerëson se në rastin në fjalë Komuna e Prishtinës po ashtu në kundërshtim me dispozita ligjore nuk merr vendim lidhur me kërkesë por në tentim për ti ikur përgjegjësisë e referon rastin tek e paditura. Megjithatë e paditura do të duhej të merrte një vendim qoftë si organ mbikëqyrës i Komunës së Prishtinës që ta kthente çështjen në rivendosje por nuk ka të drejtë të heshte për një kërkesë të parashtruar të njëjtës. Sipas LKA, Neni 29 paragrafi 3 përcakton *nëse organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa nuk e nxjerr as në afatin e mëtejme prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t'i është refuzuar ankesa*. Prandaj, konform nenit 65 të LKA-së e paditura obligohet që ta shqyrtoj kërkesën e paditësit të referuar nga Komunës së Prishtinës të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm nëse paditësi i plotëson kushte për tu kompensuar për dëmin e konstatuar dëmtuar në pemishte.

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkalës së Dytë e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar pretendimet në padi, në drejtim të thënieve në padi, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka aprovuar padinë e paditësit dhe ka obliguar te padituri, që në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, të vendos lidhur me ankesën e paditësit të datës 28.06.2021, të paraqitur nga paditësi “T7” Sh.P.K., dhe vendimin t’ia dorëzojë paditësit sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, ka shqyrtuar pretendimet ankimore paditurës por nuk i aprovoi këto pretendime si të bazuara. Aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm dhe ka ofruar arsyetim të mjaftueshëm për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Në ankesën e paraqitur, e paditura nuk ka arritur të paraqesë argumente të kundërta ndaj atyre që i ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë. Këto shpjegime janë në përputhje me dispozitat ligjore, ndërsa me të drejtë është aprovuar si të bazuara pretendimet e paditësit lidhur me heshtjen administrative, pasi që i padituri nuk ka vendosur për ankesën e parashtruar nga paditësi. Sipas LKA, Neni 29 paragrafi 3 përcakton *nëse organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa nuk e nxjerr as në afatin e mëtejshëm prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t'i është refuzuar ankesa.*

Edhe kolegji i kësaj gjykate pajtohet me qëndrimet faktike dhe juridike të gjykatës së shkallës së parë se Komuna e Prishtinës me datë 19.02.2021, e ka njoftuar paditësin J.H. se sa i përket kërkesës së tij të datës 24.12.2020 Drejtoria e Bujqësisë në mungesë të mjeteve financiare lëndën me nr. të referencës 04-31/01-0091992/17 e ka përcjellë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Kërkesë për shqyrtimin e lëndës nga parashtruesi i kërkesës J.H. për MBPZHR me datë 02.03.2021, ku i njëjti i është drejtuar kësaj Ministrie ta shqyrtoj lëndën me nr. të referencës 04-31/01-0091992/17 për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga ngricat e vonshme në fermën-pemishten në fshatin Besi, Komuna e Prishtinës. Gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit për shkak të heshtjes administrative është e bazuar dhe se paditësit nga e paditura i është mohuar e drejta për marrjen e një vendimi nga Komuna e Prishtinës dhe MMPH-ja si e drejtë e garantuar sipas me dispozitat ligjore dhe kushtetuese.

Kurse, sa i përket pretendimeve tjera ankimore se gjykata e shkallës së parë për, ky kolegji nuk i aprovoi sepse vlerësoi se janë të pabazuara dhe pa ndikim në vërtetimin e gjendjes faktike nga ajo e vetëtuar edhe nga gjykata e shkallës së parë, për shkak se e paditura nuk ka vendosur brenda afateve ligjore të përcaktuara me ligj, dhe si rezultat i kësaj i ka mohuar paditësit shqyrtimin e kërkesës në procedurë administrative. Andaj, aktgjykimi i ankimuar është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadiisë së paditësit, me të cilin e ka obliguar të paditurin që në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, ta shqyrtoj kërkesën nga parashtruesi J.H. B.I të dorëzuar në MBPZHR me datë 02.03.2021 e paditësit e paditësit për shqyrtimin e lëndës të merr vendim dhe të njëjtin, t'ia dorëzoj paditësit dhe Komunës së Prishtinës, sipas procedurës së përcaktuar me ligj dhe ta njoftoj gjykatën.

Kolegji vlerëson gjykata e shkallës së parë përfundimin e tërë kësaj procedure e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme dhe se mbi bazën e gjendjes faktike të konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale. Përfundimisht, Gjykata e Komerciale e Kosovës i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të

kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim apo të vendoset ndryshe.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 195 par. 1 pika (d) e LPK-së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1380/25, me datë 15.01.2026

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi d.v.